



KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranica e Prandës, M- Uana 16-12-2024			
Tirësi i Aplikimit Detyrues	Numri i Prandës	Numri i Aplikimit	Vlera e Prandës
02-111	01-	-	1446



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti

Në bazë të Rregullorës për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Vitisë nr. 01-013/246 neni 3,6,8,9 dhe neni 10, si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Komuna e Vitisë shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë për vitin akademik 2024/25

Komuna e Vitisë shpallë konkurs publik për ndarjen e 150 bursave, (vlera e një burse 300 €), për vitin akademik 2024/25. Bursat ndahen për studentë të rregullt, për studentë të drejtimeve deficitare (Matematikë, Fizikë, Gjuhë gjermane), për studentë të familjeve përfituese të ndihmës sociale, studentë të familjeve të dëshmorëve të luftës, invalid të luftës dhe veteranë të luftës, si dhe studentë të familjeve pa prindër në jetë.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë student i rregullt me adresë banimi në Komunën e Vitisë,
- Të jenë studentë të rregullt në Universitete Publike të Republikës së Kosovës

- Përparësi do të kenë:

- Drejtimet deficitare: Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane,
- Studentët me notë mesatare më të lartë,
- Studentë të prindërve të kategorive të dala nga lufta,
- Studentë përfitues të ndihmës sociale,
- Studentë të familjeve pa prindër në jetë,
- Dy ose më shumë studentë të së njëjtës familje (përfitues do të jetë vetëm njëri nga studentët)

Vërejtje: Nuk do të jenë përfitues të bursës komunale studentët përfitues të bursës universitare dhe bursave tjera, studentë të universiteteve private, studentë të nivelit postdiplomike (Master, PHD).

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi kopje),
- Certifikatë e vendbanimit,
- Certifikata e notave,
- Për studentët fillestar diploma e shkollës së mesme,
- Vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin akademik 2024/2025,
- Dëshmi mbi gjendjen ekonomike (rastet sociale),
- Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta,
- Studentët që janë pa prindër të sjellin certifikatën e vdekjes.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Arkivin e Komunës në Viti, objekti tek Komuna e re.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim.

Viti, më : 16.12.2024

Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Halit